



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

Akademia e Kosovës për Siguri Publike
Kosovska Akademija za Javnu Bezbednost / Kosovo Academy for Public Safety

PLANI I TRAJNIMEVE 2026

PLAN OBUKE 2026 - TRAINING PLAN 2026



Vushtrri, Nëntor 2025

TABELA E PËRMBAJTJES	FAQE
Parathënia e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP	3
Hyrje	4
Qëllimi	6
1. Trajnimet nga Policia e Kosovës	7
1.1 Trajnimet nga fusha e Policisë së Përgjithshme	8
1.1.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Përgjithshme e Policisë së Kosovës	9
1.2 Trajnimet nga fusha e Shkathësive Operative	10
1.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Shkathësive Operative	11
1.3 Trajnimet nga fusha e Trafikut	12
1.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Trafikut	13
1.4 Trajnimet nga fusha e Hetimeve	14
1.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Hetimeve	15
1.5 Trajnimet nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershit	17
1.5.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershit	18
1.6 Trajnimet nga fusha e Policisë Kufitare	19
1.6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Policisë Kufitare	20
1.7 Trajnimet nga Fusha e Standardeve	21
1.7.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Standardeve	22
1.8 Trajnimet nga fusha e Njësive të Specializuara	23
1.8.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Njësive të Specializuara	24
1.9 Trajnimet nga fusha e Armëve të Zjarrit	25
1.9.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Armëve të Zjarrit	26
2. Trajnimet nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	27
2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave	28
3. Trajnimet nga Inspektorati Policor i Kosovës	30
3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Inspektorati Policor i Kosovës	31
4. Trajnimet nga Shërbimi Korrektues i Kosovës	32
4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës	33
4.2 Trajnimet të cilat do të realizohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në Q.T. Dubravë	34
5. Trajnimet nga Shërbimi Sprovues i Kosovës	35
5.1 Trajnimet e Planifikuara për vitin 2026 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës	36
6. Trajnimet nga Dogana e Kosovës	37
6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Dogana e Kosovës	38
7. Trajnimet nga Partnerët Ndërkombëtar	39
7.1 Trajnimet nga OSBE	40
7.2 Trajnimet e Njësitit Special Këshillues	41
7.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Njësitit Special Këshillues	42
7.3 Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi	43
7.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi	44
7.4 Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim	45
7.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim	46
8. Trajnimet e Përbashkëta	48
8.1 Trajnimet e përbashkëta të planifikuara për vitin 2026	49
9. Përmbledhja e Planit të Trajnimit të AKSP për vitin 2026	51

PARATHËNIA E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AKSP

Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2026 paraqet dokumentin themelor që udhëheq programet dhe veprimtaritë trajnuese të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për të gjitha institucionet e sigurisë publike në vend. Ky plan është rezultat i një procesi të koordinuar ndërmjet AKSP-së, Institucioneve të Sigurisë dhe partnerëve ndërkombëtar, duke u bazuar në mandatin ligjor të AKSP-së dhe nevojat e identifikuara për zhvillimin profesional të zyrtarëve të sigurisë.

Në përgatitjen e këtij plani, është synuar të sigurohet një qasje e balancuar ndërmjet trajnimeve profesionale dhe trajnimeve tjera, me qëllim të mbajtjes së standardeve të larta të performancës.

Plani i Trajnimeve për vitin 2026 synon të sigurojë vazhdimësi, stabilitet dhe koherencë në kualifikimin e personelit të institucioneve të sigurisë, duke ofruar programe që përforcojnë kompetencat profesionale. Ky dokument është një udhërrëfyes për zhvillimin e kapaciteteve që u mundëson institucioneve të përmbushin me përgjegjësi detyrat e tyre ligjore dhe misionin në shërbim të qytetarëve.

Shpreh falënderimin për të gjitha institucionet e sigurisë dhe partnerëve ndërkombëtar që kanë kontribuar në hartimin e këtij plani dhe për bashkëpunimin e vazhdueshëm në ngritjen e kapaciteteve profesionale. Njëkohësisht, vlerësoj përkushtimin e stafit të AKSP-së për punën e tyre të vazhdueshme në realizimin e misionit të institucionit.

Jemi të bindur se Plani Vjetor i Trajnimeve për vitin 2026 do të kontribuojë fuqishëm në ngritjen e kapaciteteve profesionale të të gjitha institucioneve të sigurisë publike dhe do të mbështesë përpjekjet tona të përbashkëta për një vend më të sigurt, më të qëndrueshëm dhe me standarde të larta të integritetit institucional.

Shpend Shabani

U.d. i Drejtorit të Përgjithshëm të AKSP-së

HYRJE

“Trajnimi dhe puna e përbashkët është frymëzuese”

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është institucion i formuar me Ligjin nr. 04/L-053 për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, përgjegjës për ofrimin e trajnimeve dhe arsimit të lartë, zbatimin e politikave dhe strategjive të trajnimit, arsimimit të lartë si dhe zhvillimin e kapaciteteve në fushën e sigurisë publike.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ofron trajnime dhe arsim të lartë për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike por pa u kufizuar vetëm në: Policinë e Kosovës, Doganën e Kosovës, Inspektoratin Policor të Kosovës, Agjencinë për Menaxhim Emergjent, Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Shërbimin Sprovues të Kosovës.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike zotohet të sigurojë cilësi të lartë profesionale gjatë trajnimeve në menaxhimin institucional, si dhe në shpërndarjen e burimeve për të gjitha Institucionet e Sigurisë Publike, gjithashtu është përgjegjëse për të siguruar standarde profesionale për arsimimin e të gjithë pjesëtarëve të Institucioneve të Sigurisë Publike.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka një histori unike dhe me qëllim të sqarimit sa më të thuket të saj e kemi ndarë në dy kategori të dallueshme:

➤ Zhvillimi institucional dhe zhvillimi edukativo-arsimor.

Kategoria e parë, zhvillimi institucional përfshin historinë e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike e cila ka kaluar nëpër tri faza: para vitit 1999, nga viti 1999-2006, dhe prej vitit 2006 e këtej.

Përfundimisht në vitin 2008 Akademia e Kosovës për Siguri Publike u bë agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, një qendër e arsimit dhe trajnimit për Institucionet e Sigurisë Publike të Kosovës.

Ndërtimi dhe zhvillimi i kapaciteteve përmes trajnimeve dhe kurseve profesionale, si dhe forcimi i bashkëpunimit me ICITAP, OSBE dhe institucionet e tjera ndërkombëtare, është bërë me qëllim

të avancimit të mëtejshëm profesional, prandaj ato do të jenë edhe prioritet i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike gjatë viteve në vijim.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike ka për qëllim krijimin e një sigurie përmes fushës së arsimimit dhe bashkëpunimeve me institucionet e ngjashme në rajon dhe më gjerë, për të shkëmbyer përvojat dhe për të zhvilluar rrjetin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

QËLLIMI

Qëllimi i këtij plani të trajnimeve është planifikimi, organizimi dhe implementimi i analizës së nevojave të trajnimeve për Institucionet e Sigurisë Publike në fushën e ngritjes dhe avancimit të zyrtarëve të saj përmes trajnimeve të ndryshme.

Plani i trajnimit është një dokument unik i përfshirjes së të gjitha trajnimeve të planifikuara në baza vjetore përmes së cilët arrihet një pasqyrë mbi fushat e trajnimit, kohëzgjatjen e trajnimit, grupet e synuara dhe hapësirat e zhvillimit të trajnimit.

Plani i Trajnimit është dokument i Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, i cili hartohet në bashkëpunim me Institucionet e Sigurisë Publike dhe Partnerët Ndërkombëtarë, që përmbush nevojat e adresuara për pjesëmarrje në trajnimet e parapara dhe të planifikuara bazuar në interesat e Institucioneve përkatëse të sigurisë publike.

Plani i trajnimeve paraqet koordinimin dhe bashkëpunimin në mes të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Institucioneve të Sigurisë Publike dhe Partnerëve Ndërkombëtarë në fushën e trajnimeve, përmes së cilit rritet efikasiteti dhe efektiviteti i zyrtarëve të sigurisë publike në përditshmërinë e zbatimit të detyrave zyrtare.

Zhvillimi i trajnimeve të Institucioneve të Sigurisë Publike në një institucion të vetëm, siç është Akademia e Kosovës për Siguri Publike, mbi të gjitha rezulton me koordinimin e mirëfilltë dhe racional të shërbimeve profesionale dhe mbështetëse të cilat i ofron Akademia e Kosovës për Siguri Publike për Institucionet e Sigurisë Publike.



POLICIA E KOSOVËS



1. TRAJNIMET NGA POLICIA E KOSOVËS

Trajnimet nga Policia e Kosovës përbejnë një grup trajnimesh që ofrojnë njohuri bazike, të avancuara dhe të specializuara në fusha të ndryshme me një gamë të gjërë trajnimesh nga ajo e përgjithshme e gjerë tek fusha e specializuar.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do fitojnë njohuri themelore të zyrtarit policor, legjislacionit, shkathtësive operative, trafikut, hetimeve, menaxhmentit dhe lidërshit, policisë kufitare, standardeve, njësive të specializuara dhe armëve të zjarrit.

Në përgjithësi vijuesitë e trajnimeve do të fitojnë aftësi dhe njohuri me procedurat e ndryshme që ndërlidhen me punën dhe detyrat e zyrtarit policor në të gjitha dikasteret gjegjëse aktuale të Policisë së Kosovës.

TRAJNIMET:

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do mund të trajnohen në këto fusha:

- 1.1 Fusha e Përgjithshme;
- 1.2 Fusha e Shkathtësive Operative;
- 1.3 Fusha e Trafikut;
- 1.4 Fusha e Hetimeve;
- 1.5 Fusha Menaxhment dhe Lidërshit;
- 1.6 Fusha e Policisë Kufitare;
- 1.7 Fusha e Standardeve;
- 1.8 Fusha e Njësive të Specializuara;
- 1.9 Fusha e Armëve të Zjarrit;

1.1 TRAJNIMET NGA FUSHA E POLICISË SË PËRGJITHSHME

Trajnimet në fushën e përgjithshme përbejnë një grup trajnimesh ku kadetët do të njihen me anën teorike dhe praktike si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë e zyrtarit policor në trajnimin themelor për zyrtar policor.

Në këtë fushë të trajnimeve gjithashtu vijuesit do të fitojnë njohuri edhe në trajnimin polici i parë në vendin e ngjarjes si dhe në trajnimin për policimin në bashkësi.

GRUPET E SYNUARA:

- Kadetët Policor;
- Zyrtar Policor;

1.1.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Përgjithshme e Policisë së Kosovës

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuuar të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Trajnimi Themelor për Zyrtar Policor	6 muaj	1	350	Th	Gjatë vitit													AKSP
2	Polici i Parë në Vendin e Ngjarjes	1 javë	1	15	Th		23-27												AKSP
3	Kursi i Policisë në Bashkësi	2 javë	1	15	Th									01-12					AKSP

1.2 TRAJNIMET NGA FUSHA E SHKATHTËSIVE OPERATIVE

Trajnimet në fushën e shkathtësive operative përbëjnë një grup trajnimesh të cilat janë kryesisht të fokusuara në fitimin e njohurive themelore për ndihmën e parë si dhe të taktikave mbrojtëse.

Në kuadër të këtij grupi të trajnimeve ofrohen trajnimet në trajnimin e instruktoreve të rinjë në taktika mbrojtëse dhe vijuesitë të cilët i nënshtrohen këtij trajnimi do të jenë në gjendje të përcjellin njohuritë dhe shkathtësitë e fituara tek zyrtarët tjerë në ngritjen e nivelit profesional në kryerjen e detyrave të tyre si dhe do të trajnohen edhe në tajnimit themelor për ndihmë të parë.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Shkathtësive Operative

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
4	Trajnimi Themelor për Ndihmën e Parë	1 javë	1	15	Th	19-23													AKSP
5	Kursi Instruktor i Taktikave Mbrojtëse dhe Ushtrimeve Fizike	10 javë	1	15	T		03											ShKK	AKSP

1.3 TRAJNIMET NGA FUSHA E TRAFIKUT

Trajnimet në fushën e trafikut përbëhen nga një grup trajnimesh të cilat përveç njohjes me elementet bazë të rregullave në trafik ofrojnë mundësinë e ngritjes profesionale në menaxhimin e trafikut dhe hetimet e aksidenteve, ngasjes emergjente si dhe ngasjes emergjente me mjete të blinduara, trajnim për skuter (motorra), manipulimit me dron, pastaj përdorimin e paisjeve për laser dhe alkotest, analizën e aksidenteve të komunikacionit rrugor si dhe trajnim për motoçiklistë (motorra).

Vijuesitë të cilët i nënshtrohen këtyre trajnimeve do kenë mundësinë që përkrah pjesës teorike të zhvillojnë edhe anën praktike e cila do aplikohet në poligonet e AKSP si dhe në rrugë të hapura.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;
- Zyrtar nga Inspektorati Policor i Kosovës;

1.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Trafikut

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
6	Menaxhimi i Trafikut dhe Hetimi i Aksidenteve	4 javë	1	15	A	13				05-30								OSBE	AKSP
7	Trajnimi Ngasja Emergjente	1 javë	6	90	A	Gjatë vitit												ShKK, AME	AKSP
8	Trajnim për Skuter	3 javë	1	/	Th	Gjatë vitit													AKSP
9	Trajnimi Ngasja Emergjente me Mjete të Blinduara	1 javë	1	15	A				06-10									DK	AKSP
10	Manipulimi me Dron	1 ditë	1	10	/		16												AKSP
11	Trajnimi për Laser dhe Alkotest	2 ditë	1	15	Th			02-03											AKSP
12	Trajnimi Analiza e Aksidenteve të Komunikacionit Rrugor	4 javë	1	15	A									01-25					AKSP
13	Trajnim për Motoçiklistë (motorra)	8 javë	1	10	/	Gjatë vitit													AKSP

1.4 TRAJNIMET NGA FUSHA E HETIMEVE

Trajnimet në fushën e hetimeve janë trajnime të nivelit bazik, të avancuar dhe të specializuar përmes së cilave vijuesitë e trajnimeve do arrijnë nivelin e duhur profesional në këtë fushë për të performuar detyrat në vendin e punës.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do kenë mundësinë që përveç trajnimit themelor të hetimit të krimit, të fitojnë njohuri edhe në trajnimin e avancuar të hetimit të krimit, pastaj hetimin e dhunës në familje, hetimin e vrasjeve, hetimit të zjarrit dhe zjarrëvënies, hetimin e korrupsionit, trajnimin bazik kundër terrorizmit, nxitjes së gjurmëve latente me kemikale, krim teknik të vendit të ngjarjes, hetimin e krimit të urrejtjes, qendrat e ndalimit, delikuenca e të miturve, teknikat e intervistimit, trajnimi për inteligjencë, hetimin e krimeve kibernetike per reaguesit e parë, hetimi i krimeve kibernetike dhe krimeve qe mundesohen nga interneti, hetimi i fshehtë, krimet mjedisore, intervistimi hetimor i të miturve dhe menaxhimi i dhomave të intervistimit si dhe në hetimin e trafikimit me njerëz.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Hetimeve

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
14	Trajnim Themelor i Hetimeve të Krimit	4 javë	1	15	Th	19													AKSP
15	Trajnimi i Avancuar i Hetimit të Krimit	3 javë	1	15	A				06-24										AKSP
16	Trajnimi Hetimi i Dhunës Familjare	1 javë	1	15	A		09-13												AKSP
17	Kursi Hetimi i Vrasjes	2 javë	1	15	S									14-25					AKSP
18	Kursi Hetimi i Zjarreve dhe Zjarrvënjeve	1 javë	1	15	S						08-12								AKSP
19	Trajnimi i Hetimit të Korrupsionit	1 javë	1	15	A										05-09			DK	AKSP
20	Kursi Bazik Kundër Terrorizmit	1 javë	1	15	Th					11-15									AKSP
21	Trajnim për Nxitjen e Gjurmëve Latente me Kemikale	1 javë	1	15	/				20-24										AKSP
22	Trajnimi Krimteknikët e Vëndit të Ngjarjes	6 javë	1	15	A					04									AKSP
23	Trajnimi për Hetimin e Krimeve të Urrejtjes	2 ditë	1	15	Th	26-27													AKSP

24	Trajnimi Qendrat e Ndalimit	1 javë	1	15	Th					18-22									AKSP
25	Kursi Delikuenca e të Miturve	1 javë	1	15	A			09-13											AKSP
26	Trajnimi i Specializuar Teknikat e Intervistimit	1 javë	1	15	S							13-17						DK	AKSP
27	Kursi i Inteligjencës	1 javë	1	15	S					01-05								DK	AKSP
28	Hetimi i Krimeve Kibernetike për Reaguesit e Parë	2 ditë	1	15	/						01-02								AKSP
29	Hetimi i Krimeve Kibernetike dhe Krimeve që Mundesohen nga Interneti	1 javë	1	15	A						08-12								AKSP
30	Hetimi i Fshehtë	/	/	/	/	Gjatë vitit													AKSP
31	Trajnimi Krimet Mjedisore	1 ditë	1	15	/	Gjatë vitit													AKSP
32	Trajnimi Intervistimi Hetimor i të Miturve dhe Menaxhimi i Dhomave të Intervistimit	1 javë	1	15	A	Gjatë vitit													AKSP
33	Trajnimi Hetimi i Trafikimit me Njerëz	1 javë	1	15	A		02-06												AKSP

1.5 TRAJNIMET NGA FUSHA E MENAXHIMIT DHE LIDERSHIPIT

Trajnimet në fushën e menaxhimit dhe lidershipit përbejnë një grup trajnimesh të niveleve të ndryshme menaxheriale të cilat ofrojnë mundësinë e përgatitjes së menaxherëve të rinjë si dhe menaxherëve ekzistues në ballafaqimin dhe menaxhimin e sfidave të ndryshme në punën e përditshme në vendimmarrje, planifikim si dhe organizim brenda organizatave ku ata veprojnë.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do kenë mundësinë të fitojnë njohuri në trajnimin për menaxhimin e vijës së parë, vijës së mesme, në planifikim operativ si dhe sjelljen me njerëz dhe detyrat në vendin e punës.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.5.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Menaxhimit dhe Lidershipit

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuar të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
34	Menaxhimi i Vijës së Parë (Reshter)	4 javë	1	15	Th	Gjatë vitit												ShKK, DK	AKSP
35	Menaxhimi i Vijës së Mesme	5 javë	/	/	A	Gjatë vitit												ShKK, DK	AKSP
36	Trajnimi për Planifikim Operativ	1 javë	1	15	A		23-27											DK	AKSP
37	Sjellja me Njerez dhe detyrat në Punës	1 javë	1	15	Th			23-27										ShKK, DK	AKSP

1.6 TRAJNIMET NGA FUSHA E POLICISË KUFITARE

Trajnimet në fushën e policisë kufitare janë trajnime të cilat ndërlidhen kryesisht me detyrat e zyrtarëve policor kufitar dhe ofrojnë njohuri bazike dhe të avancuara për zyrtarët e policisë kufitare si dhe mbikëqyrjen kufitare.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të trajnohen dhe fitojnë njohuri në trajnimin e avancuar për mbikëqyrjen e kufirit, trajnimin për trajner Imuniteti Diplomatik në Kosovë, pastaj në leximin e hartave dhe orientimi në hapësirë, dokumenteve të falsifikuara si dhe migrimin dhe kontrabandimin me migrantë.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Policisë Kufitare

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
38	Trajnimi i Avancuar për Mbikqyrjen e Kufirit	2 javë	1	15	A								10-21						AKSP
39	Trajnim për Trajner Imuniteti Diplomatik në Kosovë	2 ditë	1	15	/	Gjatë vitit												DK	AKSP
40	Trajnim Leximi i Hartave dhe Orientimi në Hapësirë	3 ditë	1	15	/					25-27									AKSP
41	Kursi Bazik i Dokumenteve të Falsifikuara	1 javë	1	15	B						08-12							DK	AKSP
42	Migrimi dhe Kontrabandimi me Migrant	1 javë	1	15	A			16-20											AKSP

1.7 TRAJNIMET NGA FUSHA E STANDARDEVE

Në fushën e standardeve, zyrtarët e sigurisë publike do trajnohen në barazinë gjinore, si të veprojnë kur kanë të bëjnë me rastet e ngacmimeve seksuale në vendin e punës, komunikimin jo-verbal dhe menaxhimi i stresit, krijimin e ekipës, trajnimin për trajner për zbatim të programit fushor ndërsa në programin për aftësimin e instruktorëve do të fitojnë shkathtësitë e të qenurit instruktor ligjërues meqë përkrah anës teorike do zhvillohet edhe ajo praktike për përgatitjen e instruktorëve të rinj.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.7.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Standardeve

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
43	Kursi Barazia Gjinore	1 javë	1	15	Th							20-24						ShKK, DK	AKSP
44	Ngacmimi Seksual në Vendin e Punës	2 ditë	1	15	/		02-03											DK	AKSP
45	Programi për Aftësimin e Instrukturëve	4 javë	1	15	I	Gjatë vitit												ShKK	AKSP
46	Komunikimi Jo-Verbal dhe Menaxhimi i Stresit	1 javë	1	15	A		23-27											ShKK, DK, AKSP	AKSP
47	Kursi Krijimi i Ekipës dhe Menaxhimi i Konflikteve	4 ditë	1	15	A				07-10									DK	AKSP
48	Trajnimi për Trajner për Zbatim të Programit Fushor	2 javë	1	15	I					04-15									AKSP

1.8 TRAJNIMET NGA FUSHA E NJËSIVE TË SPECIALIZUARA

Trajnimet nga fusha e njësive të specializuara përbëjnë një grup të trajnimeve intensive.

Vijuesitë e këtyre trajnimeve do të njihen me shkathtësitë dhe aftësitë për intervenim, arrestim, bastisje dhe përcjellje në situata me rrezikshmëri të lartë si dhe do të përfitojnë njohuri për mbrojtjen e personave të rëndësishëm.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.8.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Njësive të Specializuara

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT											Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
49	Trajnim për Mbrojtje të Afërt	12 javë	1	40	A	Gjatë vitit												AKSP
50	Trajnim për Trajnerë të Mbrojtjes së Afërt	12 javë	1	5	/	Gjatë vitit												AKSP
51	Trajnim për NJSI	12 javë	1	40	Th	Gjatë vitit												AKSP
52	Trajnim për Trajnerë të NJSI	12 javë	1	5	/	Gjatë vitit												AKSP

1.9 TRAJNIMET NGA FUSHA E ARMËVE TË ZJARRIT

Trajnimet në fushën e përdorimit të armëve të zjarrit përbejnë një grup trajnimesh që kryesisht kanë si objektiv njohjen me armën e zjarrit, me origjinën, specifikat dhe informatat e nevojshme teknike, për të trajnuar zyrtarin në përdorimin, manipulimin dhe funksionimin me armë zjarri gjatë kryerjes së detyrave zyrtare dhe krahas njohjes së anës teorike me një theks të veçantë do aplikojn pjesën praktike e cila do të zhvillohet në poligonet e tipit të mbyllur dhe të hapur të AKSP, për të përgatitur vijuesin me njohuri të nevojshme në përdorimin e armëve të zjarrit në mënyrë efektive.

Për këtë vit në fushën e armëve të zjarrit është planifikuar të realizohet Trajnimi për Trajner të Armëve të Zjarrit si dhe do të trajnohen në trajnim me armë të gjata.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët Policor të Kosovës;

1.9.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga fusha e Armëve të Zjarrit

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
53	Trajnimi për Trajner të Armëve të Zjarrit	4 javë	1	15	I		03-28											ShKK	AKSP
54	Trajnimi me Armë të Gjata	4 ditë	1	15	/			02-06											AKSP



AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E EMERGJENCAVE



2. TRAJNIMET NGA AGJENCIA PËR MENAXHIM TË EMERGJENCAVE

Trajnimet në fushën e Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave përbejnë një grup trajnimesh të cilat ofrojnë njohuri bazike, të avancuara dhe të specializuara në menaxhimin e emergjencave.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do fitojnë njohuri rreth përdorimit të mjeteve themelore gjatë shuarjes së zjarreve, pastaj në zjarrfikje dhe shpëtim, bazat e menaxhimit emergjent, vlerësimin e rreziqeve, zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, shuarjen e zjarreve fushore dhe malore, reagimi në aksidentet e komunikacionit rrugor, zjarret e brendshme dhe shuarja e tyre, do të kuptojnë rolin e sistemit të integruar të menaxhimit emergjent, vlerësimin e dëmëve, do të njoftohen rreth materieve të rrezikshme si dhe planin e reagimit kombëtar, pastaj me ndihmën e parë të specializuar në sistemin e reagimit emergjent, kërkim shpëtimi sipërfaqësor, planifikimin emergjent, ngasje emergjente si dhe gjatë vitit është paraparë të bëhet edhe përgatitja e kandidatëve për dhënien e provimit profesional në lëminë e mbrojtjes nga zjarri.

Ndërsa në Trajnimin Profesional për Zjarrfikës, kadetët do të njihen me anën teorike, praktike si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë e të cilit janë kryerja e punëve të zjarrfikjes dhe shpëtimit.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtarët nga Njësia Profesionale në Zjarrfikje dhe Shpëtim;
- Zyrtarët e drejtorive në nivel lokal dhe qendror;
- Zyrtarët për vlerësim të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;
- Zyrtarët për planifikim dhe parandalim të fatkeqësive;
- Ministritë, Agjencitë, Sektori Privat dhe OJQ-të;
- Insitucionet tjera;
- Personat fizikë dhe juridikë të fushës së avancimit të mbrojtjes nga zjarri;
- Kadetë në Trajnimin Profesional Zjarrfikës.

2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Agjencia për Menaxhim të Emergjencave

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Përdorimi i Mjeteve Themelore gjatë Shuarjes së Zjarreve	3 ditë	2	40	B	√								√				ShKK, AKSP	AKSP
2	Trajnimi Bazik në Zjarrfikje dhe Shpëtim	2 javë	2	40	B			√	√						√	√		ShKK	AKSP
3	Bazat e Menaxhimit Emergjent	1 javë	1	20	B		√												AKSP
4	Kursi Vlersimi i Rreziqeve	3 ditë	1	20	B				02-04										AKSP
5	Trajnimi Zvogëlimi i Rreziqeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera	2 ditë	1	20	B				11-12										AKSP
6	Trajnimi Shuarja e Zjarreve Fushore dhe Malore	3 ditë	1	20	B				√	√									AKSP
7	Trajnimi Aksidentet e Komunikacionit Rrugor	1 javë	1	20	B					√									AKSP
8	Trajnimi Zjarret e Brendshme dhe Shuarja e Tyre	1 javë	1	20	B					√									AKSP
9	Trajnimi Profesional Zjarrfikës	6-7 muaj	1	30	P								√	√					AKSP
10	Sistemi i Integruar i Menaxhimit Emergjent	1 javë	1	20	B				√										AKSP

11	Vlerësimi i Dëmëve	1 javë	1	20	A			√	√										AKSP
12	Trajnimi Materiet e Rrezikshme	4 ditë	1	20	B					√									AKSP
13	Plani i Reagimit Kombëtar	1 javë	1	20	/			√											AKSP
14	Trajnimi Ndihma e Parë e Specializuar në Sistemin e Reagimit Emergjent	1 javë	1	20	S										√				AKSP
15	Kërkim Shpëtimi Sipërfaqësor	2 javë	1	20	/											√			AKSP
16	Trajnimi Planifikimi Emergjent	1 javë	1	20	B		√												AKSP
17	Trajnimi Ngasja Emergjente	1 javë	1	20	/	Gjatë vitit													AKSP
18	Përgatitja e Kandidatëve për Dhënien e Provimit Profesional në Lëmine e Mbrojtjes nga Zjarri	5 javë	1	20	/	Gjatë vitit													AKSP



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS



3. TRAJNIMET NGA INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) është institucion i pavarur që vepron në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës.

Inspektorati Policor i Kosovës angazhohet të garantojë integritetin, profesionalizmin dhe llogaridhënien brenda Policisë së Kosovës, përmes hetimeve të pavarura dhe transparente në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e kërkuara.

Për vitin 2026 IPK ka planifikuar realizimin e Trajnimit Profesional Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës ku kadetët do të njihen me anën teorike dhe praktike si dhe me detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektorit të Inspektoratit Policor të Kosovës ndërsa gjithashtu është planifikuar edhe realizimi i Kursit të Ricertifikimit në bashkëpunim dhe me përkrahje të Policisë së Kosovës.

GRUPET E SYNUARA:

- Kadetët në Trajnimin Profesional;
- Zyrtar të Inspektoratit Policor të Kosovës;

3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Inspektorati Policor i Kosovës

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT											Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
1	Trajnimi Profesional Inspektor i Inspektoratit Policor të Kosovës	35 javë	1	25	P	Gjatë vitit												AKSP
2	Kursi i Ricertifikimit	3 ditë	3	45	B	Gjatë vitit												AKSP



SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS



4. TRAJNIMET NGA SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS

Trajnimet në fushën e Shërbimit Korrektues përbëjnë një grup trajnimesh që ofrojnë njohuri bazike, të avancuara dhe të specializuara për administrimin e të burgosurve, paraburgosurve, dënuarve, të miturve në bazë të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës, konventave evropiane dhe atyre ndërkombtare, gjithnjë duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale.

Në këtë grup trajnimesh vijuesitë do të fitojnë njohuri themelore për zyrtar korrektues gjatë trajnimit profesional ndërsa trajnimet tjera janë për ngritjen profesionale dhe avancimin e zyrtarëve përmes trajnimeve siq janë Trajnimi vlerësimi i rrezikut dhe nevojave (VRN), pastaj menaxhimi i zemërimit, intervista motivuese, biseda për ndryshime, siguria dinamike, përcjellja e të burgosurve me rrezikshmëri të lartë dhe trajnimi bazik për zyrtar social.

Shenim:

Vlen të ceket se në bashkëpunim të ShKK dhe të Mbretërisë së Danimarkës është kërkesë për një numër të trajnimeve të realizohen gjatë vitit 2026 dhe një pjesë e këtyre trajnimeve planifikohen të realizohen në AKSP.

Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19, Heckler dhe Koch MP-5 si dhe Ricertifikimi për Glock 9x19 dhe Heckler dhe Koch MP-5 planifikohen të realizohen Q.T. Dubravë.

GRUPET E SYNUARA:

- Kadetët e ri në Trajnimin Profesional Zyrtar Korrektues;
- Zyrtarët e Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Mbikqyrësitë dhe Mbikqyrësitë e Lartë;
- Udhëheqësit dhe Zyrtarët e stafit civil në Shërbimit Korrektues të Kosovës;

4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Trajnimi Profesional Zyrtar Korrektues	23 javë	2	150	P	√									√				AKSP
2	Vlerësimi i Rrezikut dhe Nevojave (VRN)	1 javë	1	20	Th			√											AKSP
3	Trajnimi Menaxhimi i Zemërimit	1 javë	3	60	Th					√				√	√				AKSP
4	Trajnimi Intervista Motivuese	3 ditë	2	30	Th			√											AKSP
5	Trajnimi Biseda për Ndryshime	3 ditë	2	30	Th				√						√				AKSP
6	Trajnimi Sigura Dinamike	3 ditë	4	80	/				√	√				√	√				AKSP
7	Trajnimi Përcjellja e Personave me Rrezikshmëri të Lartë	3 javë	1	25	S	Gjatë vitit													AKSP
8	Trajnimi Bazik për Zyrtar Social	1 javë	1	20	/					√									AKSP
9	Trajnim (Nga Mbretëria e Danimarkës)	/	4	80	/	Gjatë vitit													AKSP

4.2 Në vijim i kemi paraqitur trajnimet të cilat do të realizohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës në Q.T. Dubravë

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19	1 javë	5	75	Th			√	√	√	√			√	√	√			AKSP -Q.T. Dubravë
2	Heckler dhe Koch MP-5	1 javë	6	90	A				√	√				√	√	√			AKSP -Q.T. Dubravë
3	Ricertifikimi për Glock 9x19	/	/	/	Th	Gjatë vitit													Q.T. Dubravë
4	Ricertifikimi për Heckler dhe Koch MP-5	/	/	/	Th	Gjatë vitit													Q.T. Dubravë



SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS



5. TRAJNIMET NGA SHËRBIMI SPROVUES I KOSOVËS

Trajnimet nga Shërbimi Sprovues i Kosovës kanë për qëllim ngritjen e vetëdijes shoqërore duke bashkëpunuar me të gjitha organet e pushtetit shtetëror për humanizmin e ekzekutimit të dënimeve alternative, reduktimin e krimit, zvogëlimin e shkallës së recidivizmit dhe rritjen e përgjithshme të sigurisë për shoqërinë tonë.

Trajnimet në fushën e Shërbimit Sprovues të Kosovës përbejnë një grup trajnimesh që ofrojnë njohuri në organizimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të masave dhe dënimeve alternative dhe të riintegritimit shoqëror të personave të dënuar.

Pjesa dërmuese e trajnimeve nga ShSK janë të bazuara në fushat gjegjëse të Shërbimit Sprovues të Kosovës ndërsa vijuesit e trajnimeve do kenë mundësinë të e vijnë trajnimin intervista motivuese, biseda për ndryshime, menaxhimi i zemërimit (këto tre trajnime do të organizohen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës), pastaj etika dhe komunikimi efektiv në Shërbimin Sprovues si dhe në trajtimin e rasteve të dhunës në familje në kuadër të Shërbimit Sprovues.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtar të Shërbimit Sprovues të Kosovës;

5.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Shërbimi Sprovues i Kosovës

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Etika dhe Komunikimi Efektiv në Shërbimin Sprovues	/	2	30	/				√					√					AKSP
2	Trajtimi i Rasteve të Dhunës në Familje në kuadër të Shërbimit Sprovues	/	2	30	/						√					√			AKSP



DOGANA E KOSOVËS



6. TRAJNIMET NGA DOGANA E KOSOVËS

Trajnimet në fushën e Doganave të Kosovës përbejnë një grup trajnimesh që ofrojnë njohuri mbi dispozitat ligjore, procedurave doganore si dhe zbatimin e tyre në praktikë.

Në këto trajnime vijuesitë do të njoftohen me teknikat dhe taktikat për zhvillimin e aftësive të nevojshme për kryerjen e detyrave doganore, do të fitojnë njohuri të përgjithshme mbi procedurat doganore si dhe klasifikimin e mallrave gjatë trajnimit të integruar të Kosovës (TARIK I dhe II), pastaj me ndryshimet në KDA dhe akteve nënligjore për zbatimin e tij, do të njoftohen me parimet themelore të përdorimit të armës së zjarrit Glock 9x19 ndërsa në kursin bazik për arrest dhe ndalim si dhe ricertifikimin e kursit bazik për arrest dhe ndalim do të zhvillojnë aftësitë dhe shkathhtësitë për implementimin e detyrave operative.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtar Doganor;

Shenim:

Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19 nga DK është planifikuar të realizohet me përkrahje nga PK ndërsa Kursi Bazik Arrest dhe Ndalim si dhe Ricertifikimi Kursi Bazik për Arrest dhe Ndalim është planifikuar të realizohet në bashkëpunim në mes DK dhe PK.

6.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga Dogana e Kosovës

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Kursi Bazik për Arrest dhe Ndalim	3 javë	1	10	B			23											AKSP
2	Trajnimi Themelor për Pistoletën Glock 9x19	1 javë	1	10	B				20-24										AKSP
3	Ricertifikimi Kursi Bazik për Arrest dhe Ndalim	3 ditë	3	48	B					18-20, 25-27	01-03								AKSP
4	Tarifa e Integruar e Kosovës - TARIK I	1 javë	2	40	B				20-24						05-09				AKSP
5	Tarifa e Integruar e Kosovës - TARIK II	1 javë	2	40	B					18-22						09-13			AKSP
6	Ndryshimet me KDA dhe Aktet Nënligjore për Zbatim të tij	3 ditë	2	40	/			30	14-16										AKSP

PARTNERËT NDËRKOMBËTAR

7. TRAJNIMET NGA PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

Akademia e Kosovës për Siguri Publike është anëtare e asociacioneve të ndryshme evropiane dhe ndërkombëtare të trajnimeve në fushën e sigurisë publike dhe zbatimit të ligjit.

Kryesisht nga partneret ndërkombëtar, në AKSP janë ofruar trajnime nga fusha të ndryshme të cilat ndërlidhen me zbatuesit e ligjit në vend, andaj trajnimet e ofruara nga partnerët ndërkombëtar kanë reflektuar me ngritjen e kapaciteteve të Agjencive të Sigurisë Publike në aspektin profesional duke ofruar edhe shkëmbim njohurish dhe praktikash të aplikuara në vendet perendimore.

Në trajnimet e ofruara nga partnerët ndërkombëtar angazhohen ekspertët e lëmive të ndryshme, ku arrihet gërshetimi i ekspertizave dhe praktikave të dëshmuara.



OSBE



7.1 TRAJNIMET NGA OSBE

Misioni i OSBE-së në Kosovë drejton një gamë të gjerë aktiviteteve, duke filluar nga mbështetja në funksionimin e institucioneve demokratike, në promovimin e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit si dhe ka një rol aktiv në forcimin e sektorit të rendit dhe sigurisë publike në Kosovë.

Misioni i OSBE-së është i angazhuar në tri fusha kryesore:

- Të drejtat e njeriut;
- Demokratizimi;
- Siguria publike;

TRAJNIMET

Në trajnimet e ofruara nga OSBE angazhohen ekspertë vendor dhe ndërkombtarë dhe me ekspertizën e tyre synohet të arrihet ngritja e kapaciteteve profesionale për Institucionet e Sigurisë Publike në fusha të ndryshme.

OSBE në kuader të misionit, për këtë vit ofron trajnime përmes këtyre njësive/sectorëve si në vijim:

- 7.2 Njësiti Special Këshillues;
- 7.3 Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi;
- 7.4 Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim;

7.2 Trajnimet nga Njësiti Special Këshillues

Faqe 40 nga 51

PLANI I TRAJNIMEVE PËR VITIN 2026

Trajnimet e ofruara për këtë vit nga Njësiti Special Këshillues kanë për qëllim ngritjen e kapaciteteve të komunikimit të institucioneve të sigurisë publike dhe sigurimin e ndërveprimit profesional, transparent dhe efektiv me publikun dhe median si dhe trajnimin e trajnerëve mbi përdorimin e përgjegjshëm të inteligjencës artificiale në institucionet e sigurisë publike.

GRUPET E SYNUARA:

- Përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, Policisë së Kosovës, Akademisë së Kosovës për Siguri Publike, Inspektoratit Policor të Kosovës si dhe Agjencisë për Menaxhim Emergjent.

Shenim:

Nga Njësiti Special Këshillues është planifikuar të realizohet edhe një punëtori tre ditore me rreth 40 pjesëmarrës për planifikim strategjik organizativ për Akademinë e Kosovës për Siguri Publike si dhe për Institucionet e Sigurisë Publike.

Kjo punëtori intensive është e dizajnuar për t'i pajisur udhëheqësit dhe vendimmarrësit me mjete dhe metodologji të avancuara për planifikim strategjik afatgjatë.

7.2.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga OSBE - Njësi Special Këshillues

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Komunikimi Proaktiv dhe Profesional me Publikun dhe Median	4 ditë	1	20	/					√								DK	AKSP
2	Trajnimi i Trajnerëve mbi Përdorimin e Përgjegjshëm të Inteligjencës Artificiale në Institucionet e Sigurisë Publike	3 ditë	1	10	/						√								AKSP

7.3 Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi

Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi gjatë vitit 2026 ka planifikuar të e realizon Trajnimin e anëtarëve të komiteteve lokale për siguri publike (KLSP) dhe komunitetit për zvogëlimin e rrezikut nga fatkeqësitë (Trajnimi Bazik i Forumeve të Sigurisë për Reagim Emergjent).

GRUPET E SYNUARA:

- Anëtarët nga Komitetet Lokale për Siguri Publike (KLSP);

7.3.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga OSBE - Sektori për Zhvillimin e Sigurisë në Bashkësi

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnimit gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT											Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	
1	Trajnime për Zvogëlimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë/ Trajnime Bazik i Forumeve të Sigurisë për Reagim Emergjent	5 ditë	1	20	/				√									AKSP

7.4 Sekori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim

Trajnimet e ofruara nga ky sektor përbëjnë një gamë të gjërë të trajnimeve të cilat kanë për qëllim ngritjen e të kuptuarit të pjesëmarrësve mbi aftësitë teknike dhe administrative të nevojshme për të zbatuar një proces të drejtë, transparent dhe të standardizuar të gradimit, pastaj zhvillimin profesional të trajnerëve të PK në përputhje me standardet e BE-së, ngritjen profesionale të zyrtarëve të PK me njohuritë dhe mjetet për të mbështetur standardet etike në policim, ndërtimin e kapaciteteve të qëndrueshme të trajnimit brenda PK, duke vazhduar me rifreskimin e trajnimit për trajnerë në përputhje me programin TAHCLE (trajnim kundër krimeve të urrejtjes për zbatues të ligjit), ngritjen e njohurive të personelit të IAP (avokatit të popullit) rreth raportimit për krimet e urrejtjes në vazhden e procesit të monitorimit të tyre, forcimin e kapaciteteve të ShKK në ofrimin e programeve efektive të rehabilitimit dhe mbështetjes psiko-sociale për të burgosurit, aftësimin e oficerëve sprovues në trajtimin e dhunuesve në familje dhe certifikimin për përdorimin e mjetit STATIC-99 për vlerësimin e rrezikut të përsëritjes së veprave penale, ngritjen e aftësive të zyrtarëve sprovues në mbikëqyrjen dhe menaxhimin e personave me histori të abuzimit me substanca për të përmirësuar rezultatet e rehabilitimit të tyre si dhe ngritjen e aftësive të zyrtarëve sprovues në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të individëve me histori radikalizmi dhe ekstremizmi, duke përdorur mjetin VERA.

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtar nga Policia e Kosovës;
- Zyrtar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës;
- Zyrtar nga Shërbimi Sprovues i Kosovës;
- Zyrtar nga Institucioni i Avokatit të Popullit;

7.4.1 Trajnimet e planifikuara për vitin 2026 nga OSBE - Sektori për Zhvillim të Policisë dhe Monitorim

Nr.	Emri i Trajnimit	Kohëzgjatja e trajnimit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesitë e planifikuara të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnimit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnimit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Trajnim për Përgatitjen e Procesit të Gradimit	3 ditë	1	20	/					√									AKSP
2	Trajnimi i Trajnerëve Certifikimi, Bazuar në standardet e Bashkimit Evropian (BE)	1 javë	1	15	/						√								AKSP
3	Trajnim mbi Etikën dhe Integritetin	1 javë	1	20	/						√							DK	AKSP
4	Trajnimi i Trajnerëve mbi Hetimin e Brendshëm për PK	1 javë	1	15	/											√			AKSP
5	Trajnimi i Trajnerëve për Krime të Urrejtjes	3 ditë	1	20	/			√											AKSP
6	Trajnim Monitorimi i Krimit të Urrejtjes	3 ditë	1	20	/						√								AKSP
7	Trajnim për Përgatitjen e Planeve Rehabilituese dhe Mbështetjen Psiko-sociale të të Burgosurve	1 javë	1	15	/			√											AKSP
8	Trajnim për Dhunën në Familje (me fokus në certifikimin për përdorimin e formularit STATIC-99)	1 javë	1	20	/				√										AKSP
9	Trajnim për Punën me Persona nën Mbikëqyrje me Histori të Abuzimit me Substanca	1 javë	1	20	/						√								AKSP

10	Trajnim për Vlerësimin e Rrezikut të Ekstremizmit të Dhunshëm (VERA)	1 javë	1	20	/									√					AKSP
----	--	--------	---	----	---	--	--	--	--	--	--	--	--	---	--	--	--	--	------



TRAJNIMET E PËRBASHKËTA



8. TRAJNIMET E PËRBASHKËTA

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve të Institucioneve të Sigurisë Publike këtë vit Departamenti i Trajnimeve dhe Përkrahjes Arsimore në kuadër të AKSP së bashku me Agjencitë e Sigurisë Publike ka identifikuar këto lloje të trajnimeve si në vijim:

- Menaxhimi i Vijës së Parë;
- Menaxhimi i Vijës së Mesme;
- Programi për Aftësimin e Instruktorëve;
- Sjellja me Njerëz dhe Detyrat në Vendin e Punës;
- Trajnimi Elementet Bazë të Menaxhimit;
- Trajnimi Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit;
- Menaxhimi i Aksidenteve Radiologjike dhe Zbulimi i Kontrabandës së Materialeve Radioaktive;
- Trajnimi Zbulimi dhe Luftimi i Kontrabandës së Materialeve Radioaktive dhe Bërthamore;
- Trajnimi Të Drejtat e Njeriut (online);
- Trajnimi Konflikti i Interesit (online);
- Trajnimi Barazia Gjinore (online);

GRUPET E SYNUARA:

- Zyrtar nga Institucionet e Sigurisë Publike (ISP);

8.1. Trajnimet e përbashkëta të planifikuara për vitin 2026

Nr.	Emri i Trajnit	Kohëzgjatja e trajnit	Numri i trajnimeve të planifikuara gjatë vitit	Vijuesit e planifikuar të trajnohen gjatë vitit	Lloji i Trajnit	PERIUDHA KOHORE PËR REALIZIMIN E TRAJNIMIT												Interesimi për pjesëmarrje në trajnime nga palët e interesit	Vendi i realizimit të trajnit
						Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor		
1	Menaxhimi i Vijës së Parë	5 javë	1	20	B			23										ISP (ShKK, DK)	AKSP
2	Menaxhimi i Vijës së Mesme	6 javë	1	20	A										19			ISP (ShKK, DK)	AKSP
3	Programi për Aftësimin e Instruktorëve	4 javë	1	20	I		09											ISP (ShKK)	AKSP
4	Sjellja me Njerëz dhe Detyrat në Vendin e Punës	1 javë	1	20	B					18-22								ISP (ShKK, DK)	AKSP
5	Trajnime Elementet Bazë të Menaxhimit	1 javë	1	20	B						08-12							ISP (ShKK, DK)	AKSP
6	Trajnime Ndërgjegjësimi, Parandalimi dhe Luftimi i Korrupsionit	1 javë	1	20	B		02-06											ISP (DK)	AKSP
7	Menaxhimi i Aksidentëve Radiologjike dhe Zbulimi i Kontrabandës së Materialeve Radioaktive	3 ditë	1	20	B									07-09				ISP (DK)	AKSP
8	Trajnime Zbulimi dhe Luftimi i Kontrabandës së Materialeve Radioaktive dhe Bërthamore	1 javë	1	20	A		09-13											ISP (DK)	AKSP

9	Trajnimi Të Drejtat e Njeriut (online)	1 ditë	1	20	/		√											DK, AKSP	AKSP
10	Trajnimi Konflikti i Interesit (online)	1 ditë	1	20	/					√								AKSP	AKSP
11	Trajnimi Barazia Gjinore (online)	1 ditë	1	20	/									√				DK, AKSP	AKSP

9. Përmbledhja e Planit të Trajnimit të AKSP për vitin 2026

Nr	Agjencitë dhe Partnerët ndërkombtarë	Numri i përgjithshëm i trajnimeve	Numri i përgjithshëm i vijuesëve
1	Policia e Kosovës	57	1195
2	Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave	20	410
3	Inspektorati Policor i Kosovës	4	70
4	Shërbimi Korrektues i Kosovës	20	495
5	Shërbimi Sprovues i Kosovës	4	60
6	Dogana e Kosovës	11	188
7	OSBE	13	235
8	Trajnimet e Përbashkëta	11	220
Gjithsej		140	2873

Në kuadër të tabelës së mësipërme janë paraqitur trajnimet e Agjencive të Sigurisë Publike dhe Partnerëve Ndërkombëtarë.

Për nevoja të ASP gjatë vitit 2026 mund të kemi kërkesa për realizim edhe të trajnimeve tjera të paplanifikuara të cilat nuk figurojnë në Planin e Trajnimeve për vitin 2026.

Akademia e Kosovës për Siguri Publike varësisht nga mundësitë buxhetore/infrastrukurore dhe prioritetet e ASP do të implementojë planin e trajnimeve për vitin 2026.